 <p>Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: info@albanianaccreditation.gov.al</p>	<p>Politika për pjesëmarrjen në krahasimet ndërlaboratorike dhe testet e zotësisë</p>	Kodi DA-PO-007
		Rishikim nr 0 Dt ____/____/____
		Faqe 1 nga 3

Politika për pjesëmarrjen në krahasimet ndërlaboratorike dhe testet e zotësisë.

1. Qëllimi

Ky dokument përshkruan politikën e Drejtorisë së Akreditimit në lidhje me skemat e testeve të zotësisë dhe krahasimeve ndërlaboratorike dhe pjesëmarrjen e laboratorëve kalibrues dhe testues.

2. Referimet

Ky dokument bazohet në EA-2/10 “EA Policy for participation in National and International Proficiency testing Activities” dhe në paragrafin 7.15 të standardit ISO 17011.

Në këtë dokument përdoren përkufizimet e mëposhtme sipas ISO/IEC Guide 43-1:1997

- Testi i zotësisë është përcaktimi i performancës së laboratorit nëpërmjet krahasimeve ndërlaboratorike
- Krahasimi ndërlaboratorik është organizimi, kryerja dhe vlerësimi i testeve mbi të njëjtën mostër ose mbi mostër të ngjashme nga dy ose më shumë laboratore në përputhje me kushtet e paracaktuara.


3. Kriteria të pranimit të organizuesve të testeve të zotësisë.

3.1 DA pranon ato organizatorë të testeve të zotësisë të cilët plotësojnë kërkesat e ISO/IEC Guide 43-1 dhe të ILAC G13:2000. Organizatorët e këtyre skemave duhet të zbatojnë një sistem të menaxhimit të cilësisë i cili siguron plotësimin e kërkesave që përfshihen në dokumentat e sipërpërmendur.

3.2 DA pranon organizatorët të cilët janë të akredituar sipas ISO/IEC Guide 43-1 dhe ILAC –G-13:2000

3.3 Në rastin kur skemat e testeve të zotësisë janë organizuar nga një organizator i pa akredituar, laborator i pjesëmarrës duhet ta ketë vlerësuar organizatorin në përputhje me kërkesat e standardeve dhe udhëzuesve të përmendur në pikën 3.1. Përputhshmëria e organizatorit demonstron nga përgatitja e informacionit të dokumentuar në lidhje me:

- Zbatimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë
- Eksperience e konfirmuar në organizimin e skemave të testeve të zotësisë.
- Të dhëna për përgatitjen dhe trajtimin e mostrave

 <p>Drejtoria e Akreditimit</p> <p>Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: info@albanianaccreditation.gov.al</p>	<p>Politika për pjesëmarrjen në krahasimet ndërlaboratorike dhe testet e zotësisë</p>	<p>Kodi DA-PO-007</p> <hr/> <p>Rishikim nr 0 Dt ____/____/____</p> <hr/> <p>Faqe 2 nga 3</p>
-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------

- Analiza e të dhënave të testimit dhe përcaktimi i performancës së laboratorit
- Përcaktimi i vlerave referuese dhe pasigurive referuese nga laboratorët testues dhe kalibrues për të demonstruar gjurmueshmërinë e matjeve të tyre në përputhje me kërkesat e ISO/IEC 17015:2005.

Informacioni i mësipërm mblidhet nga laboratorit pjesëmarrës dhe vlerësohet nga DA.

4. Detyrimet e laboratorit testues/kalibrues

4.1 Laboratorët testues/kalibrues, të akredituar apo që janë në vlerësim, duhet të demonstronjë performancën e tyre nëpërmjet pjesëmarrjes në skema të përshtatshme të zotësisë nëpërmjet krahasimeve ndërlaboratorike të organizuar nga organizatorë të besueshëm sipas kritereve të dhëna në pikën 3.


4.2 DA e ka detyrim të informojë laboratorët e akredituar dhe ato që janë në vlerësim për skemat e organizuara nga EA. Ky informacion mund të merret edhe nga faqja e internetit e EA.

4.3 Pjesëmarrja e laboratorit në të paktën 1 test zotësie për tipin e testimit/ kalibrimit që laboratorit kërkon të akreditohet është një kusht paraprak për dhënien e akreditimit. DA merr në konsideratë edhe shpeshhtësinë dhe mundësinë e organizimit të testeve të tilla. Vlerësimi nga DA për performancën e laboratorit bëhet sipas pikës 5.

4.4 Ndërmjet dy vlerësimeve për akreditim nga DA, laboratorit duhet të marrë pjesë të paktën në një test zotësie me një frekuencë të tillë për të siguruar performancën e tij për analizat kryesore brenda fushës së akreditimit. Analizat kryesore caktohen nga DA në bashkëpunim me laboratorin duke patur parasysh edhe mundësinë e organizimit të testeve të tilla.

4.5 DA inkurajon laboratorët e akredituar dhe ato që janë në vlerësim të marrin pjesë në skemat e zotësisë të organizuara nga organizatorë që plotësojnë kushtet e përmendura në pikën 3.

4.6 Ndërmjet dy vlerësimeve pjesëmarrja e laboratorit është më e rëndësishme në rastet kur ekzistojnë dyshime rreth kompetencës teknike të laboratorit (si p.sh ndryshime në personel, vlefshmëri jo e përshtatshme e metodave të përdorura, rezultate jo të kënaqshme nga testet e mëparshme, etj).

 <p>Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: info@albanianaccreditation.gov.al</p>	<p>Politika për pjesëmarrjen në krahasimet ndërlaboratorike dhe testet e zotësisë</p>	<p>Kodi DA-PO-007</p> <hr/> <p>Rishikim nr 0 Dt ____/____/____</p> <hr/> <p>Faqe 3 nga 3</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------

4.7 Laboratorët e akredituar dhe laboratorët që janë në vlerësim janë përgjegjës për gjetjen e skemave të zotësisë. Për të ndihmuar laboratorët DA ka krijuar një tabelë në faqen e saj të internetit.

5. Përdorimi i rezultateve në vlerësimin e laboratorit

5.1 Vlerësimi i rezultateve nga pjesëmarrja e laboratorit në një skemë kryhet nga grupi i vlerësimit të DA. Kryevlerësuesi përfshin në raportin final të tij një vlerësim të shkurtër të performancës së laboratorit duke bashkëngjitur edhe rezultatet.

5.2 Rezultatet e pjesëmarrjes në skemat e zotësisë merren parasysh në propozimin për dhënien e akreditimit. Për vlerësimin e rezultateve zbatohen rregullat e mëposhtme:

- Pjesëmarrja e suksesshme e laboratorit konsiderohet pozitive në propozimin final për dhënien e akreditimit
- Në rastet kur laboratori prezanton një përqindje të ulët të rezultateve të pasuksesshme në krahasim me rezultatet totale, grupi i vlerësimit vlerëson veprimet korrigjuese dhe efektivitetin e tyre. Nëse interpretimi dhe veprimet e laboratorit janë të përshtatshme, propozimi për dhënien e akreditimit nuk ndikohet nga rezultatet e pasuksesshme në testet e zotësisë dhe laboratorit i kërkohet të marrë pjesë përsëri në testin përkatës deri në vizitën mbikqyrëse të rradhës.
- Në rast se laboratori paraqet rezultate të pasuksesshme në pjesën më të madhe të testeve të zotësisë, në propozimin final do të kërkohet reduktimi i fushës së akreditimit deri në pjesëmarrje të suksesshme të laboratorit në testet përkatëse.
- Rezultatet nga testet e zotësisë nuk konsiderohen si kritere të vetme për dhënien e akreditimit, por ato shërbejnë për të formuluar një gjykim objektiv për kompetencën teknike të laboratorit.

Data

Drejtori i Përgjithshëm

